

**MBI FURNIZIMIN NË TREG TË LIBERALIZUAR TË KLIENTËVE TË LIDHUR NË  
NIVELIN E TENSIONIT 35KV NGA SHOQËRIA FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË  
SH.A/OSHEE GROUP.**

Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A./OSHEE Group (në vijim FTL SH.A), regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, është krijuar nga Asambleja e Përgjithshme “OSHEE” SH.A. në zbatim të Urdhërit Nr. 157, datë 12.02.2018 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë “Mbi krijimin e tri shoqërive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A”.

“FTL” SH.A. është licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë në aktivitetin e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, respektivisht me Vendimin Nr. 198, date 03.09.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe Vendimin Nr. 199, datë 03.09.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

Shoqëria “FTL” SH.A. ofron mundësinë e furnizimit me energji elektrike për të gjithë klientët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelin e tensionit TM 35 kV, të cilët bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, kanë dalë ose duhet të dalin në tregun e liberalizuar.

Shoqëria “FTL” SH.A., pjesë e OSHEE GROUP, garanton furnizimin me energji elektrike sipas kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit të parashikuara në *“Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”*, miratuar me Vendimin e Entit Rregullator të Energjisë Nr. 181, datë 10.11.2017.

Sa më sipër, “FTL” SH.A. fton të gjithë klientët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelin e tensionit TM 35 kV dhe që janë të interesuar për shërbimin e furnizimit me energji elektrike, të kontaktojnë në adresën Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, ose në adresën e email-it [info.furnizimi@oshee.al](mailto:info.furnizimi@oshee.al).

**“FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SH.A.**